



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 384/15 Prot

Tiranë, më 13.5.2016

VENDIM

Nr. 25, datë 13.5.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit, Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit Nr.74, datë 18.03.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 12.04.2016 e në vazhdim, pranë kontrolluesit si më lart cituar filloi procedura e hetimit administrativ, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan, i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, nga grupi i inspektimit është konstatuar:

1. Kontrolluesi nuk ka njoftuar pranë Zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave personale sipas nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, detyrim të cilin e realizoi në mënyrë të menjëhershme;
2. Kontrolluesi ka një rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e spitalit, miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 1998;
3. Kontrolluesi nuk ka rregullore mbi përpunimin e të dhënave personale;
4. Kontrolluesi nuk aplikon për punëmarrësit "Deklaratën e Konfidencialitetit";

5. Kontrolluesi nuk ka rregullore në lidhje me funksionimin e arshivës fizike/kartotekës së dosjeve me të dhënat shëndetësore të pacientëve. Subjektet e të dhënave nuk mund të kenë akses apo marrin kopje të të dhënave shëndetësore përveç se nëpërmjet avokatit përkatës. Kjo është një lloj mase për mospërhapjen e të dhënave por duhet patur parasysh dhe e drejta e vetë subjektit mbi të dhënat e tij;
6. Në kontratën e furnizimit të shërbimit "Mirëmbajtje e programit të inventarizimit të të dhënave mjekësore, programi ASTRAIA", nuk ndodhet bashkëlidhur aneks-kontrata sipas Udhëzimit Nr.19 të Komisionerit;
7. Konstatohet se kompjuterat e administratës veprojnë me sisteme operative Windows, paketa office Microsoft Windows dhe antivirus jo të licencuar. Gjithashtu konstatohet se për këtë qëllim, nga stafi administrativ i kontrolluesit ka një komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me pajisjen e Spitalit Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan, me licensat përkatëse;
8. Konstatohet se në ambientet e kontrolluesit funksionon një projekt i quajtur "Telemedicina" i financuar dhe ideuar nga USAID dhe Ministria e Shëndetësisë. Në funksion të kësaj veprimtarie është një aplikacion i bazuar në "web", në të cilin ngarkohen të dhënat e pacientëve për konsultimet online nga mjekë të autorizuar. Nga grupi i inspektimit u kërkua kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt, por Spitali Rajonal Elbasan nuk e dispononte atë, pasi vetëm palët nënshkruese e dispononin atë, dhe kontrolluesi ndodhej vetëm në kushtet të zbatuesit;
9. Konstatohet se kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV) i cili administrohet nga punonjësit e brendshëm të teknologjisë dhe informacionit. Konstatohen tabela informuese në hyrje të ambienteve të mbikqyrura, por jo sipas formatit standard të miratuar në Udhëzimin Nr.3 të Komisionerit.

Faktet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 27 dhe 28 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit, Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 dhe Udhëzimit Nr.19 datë 03.08.2012 të tij.

Në cilësinë e provës materiale u disponuan dokumentet si më poshtë:

- Kontratë me punëmarrësin;
- Kontratë shërbimi për programin ASTRAIA;
- Rregullore bazë e funksionimit të Spitalit Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan;
- Pamje/foto nga ambientet e kontrolluesit dhe sistemi informatik;
- Komunikim shkresor me Ministrinë e Shëndetësisë në lidhje me licensimin e sistemeve informatike windows, office dhe antivirus;
- Inventari i dokumentacionit personal të punëmarrësit;

Në datë 28.04.2016, u mbajt procesverbal nga ana e grupit të inspektimit në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit *Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan*, në zbatim të kërkesave të Urdhrit nr.74, datë 18.03.2016 të Komisionerit.

Përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se do të merrnin masat e menjëhershme për përmbushjen në kohë reale të konstatimeve të dala nga ky hetim administrativ.

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr.8485, datë 12.05.1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, përpara marrjes së vendimit përfundimtar në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në datë 09.05.2016, është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët paraqitën dokumentacionin si vijon:

-Deklaratat e Konfidencialitetit, fotokopje me vulë institucioni të firmosura nga punëmarrësit dhe punëdhënësi titullar, konform Vendimit Nr.6, datë 05.08.2013 të Komisionerit;

-Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale të përshtatur për veprimtarinë e Spitalit Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan;

-Aneks kontratë e finalizuar për përpunimin e të dhënave personale nga një kompani e tretë, e konkretisht me kompaninë "Albanian Business Partner" sh.p.k.

Konstatimet e gjetura nga grupi i inspektimit konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kriterëve që parashikon Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 germën "*dh*" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

dh) *kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.*

Kontrolluesi, *Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan*, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën I të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me sigurinë e të dhënave personale të pacientëve, si një e drejtë parësore e tyre dhe në zbatim të ligjit e parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Komisioneri gjithashtu, ka parasysh faktin që kontrolluesi, ndryshe nga kontrollues në të njëjtën fushë, ka reaguar në kohë reale për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, ka bashkëpunuar me grupin e inspektimit, pa shmangur hetimin apo penguar atë në forma të neglizhencës.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 28, 30, 31, 39/1, 39/2, gërma "dh", si dhe neneve 40 dhe 41 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit, *Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan*, me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit, *Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan*, me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Kontrolluesi, *Spitali Rajonal "Xhafer Kongoli" Elbasan*, të realizojë tabelat e informimit në të gjitha ambjentet ku ato janë instaluar, sipas standardit të miratuar në Udhëzimin Nr.3, datë 05.03.2010 të Komisionerit.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot në, 13.5.2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
